

VENDIM
Nr.1627, datë 17.12.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI
AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t’i përfundojë, deri më 31 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për tenderin, me objekt “Blerje karburanti”, me fondet buxhetore të shpenzimeve, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha